REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 57/17
Datë/Datum. 27.02.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës se Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **DOGANA E KOSOVËS**
Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP: **201/133/16/014/111**

Sa i përket tenderit për : **"Furnizimi me uniformë për personelin e Doganës së Kosovës**

Pjesa 1.

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

"UNIKAT" SHPK
(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Rr: UÇK-së p.n
(Adresa)
PEJË — *30000*
(Vendi) — *(Kodi postar)*
049-137-782 ose 049-604-624
(Numri Telefonit) — *(Numri i Faks-it)*

ZEQIR ÇOLLAKU
(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)
unikatuniforms@hotmail.com
(Adresa elektronike)

UNIKAT Sh.p.k. PEJË

27.02.2017
(Data e parashtrimit të ankesës) — *(Nënshkrimi dhe vula)*

**Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.*

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

_____

(Emri i avokatit)

_____

(Adresa e plotë)

_____ _____

(Numri i Telefonit) *(Numri i faks-it)*

_____

(Adresa elektronike)

_____ _____

(Data e parashtrimit të ankesës) *(Nënshkrimi dhe vula)*

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim te shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar " Njoftimi për Kontratë" apo "Njoftimi për konkurs te projektimit" dhe, nëse aplikohet "Njoftimi për dhënie të Kontratës", "Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimi për anulim te aktivitetit te prokurimit", nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Njoftimi per kontrate është publikiar ne uebfaqen e KRPP-se me 29.11.2016 *Njoftimi per kontrate ne e-prokurim me 02.12.2016* *Afati i fundit për dorëzimin e tenderve ka qenë data 19.12.2016 ora 14:00* *Hapja e tenderve me 19.12.2016 ne ora 14:30* *Njoftim per eleminim dhe anulim te tenderit me 09.02.2017* *Kerkesa per rishqyrtim pran AK me 13.02.2017* *Vendimi per pezullimin e aktivitetit te prokurimit me 14.02.2017* *Njoftimi mbi vendimin e AK per refuzim te ankeses per rishqyrtim me 15.02.2017*

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, *nëse aplikohet*

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po [X] **Jo** [ ]

Gjatë procesit te hapjes se keti aktiviteti te prokurimit nuk eshte verejtur ndonje parregullsi.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, *nëse aplikohet*

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po [X] Jo [ ]

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkese për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po [X] Jo [ ]

E keni te bashkangjitur nje kopje te kerkeses per rishqyrtim dhe vendimin nga AK per rezufim te ankeses se bashku me kete ankese.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Zyra e Prokurimit pranë Doganës se Kosovës gjate vlerësimit te aktivitetit te prokurimit: **Furnizimi me uniformë për personelin e Doganës së Kosovës** **Pjesa I:Këmisha dhe kravatë,** **nuk ka vepruar konform rregullave te prokurimit, keshtu qe mendojme se jane shkelur Neni 59 Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve dhe Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë te LPP-se, njeherit nuk jane respektuar edhe neni 39,si dhe me rastin e arsyetimit per buxhet eshte vepruar kunder nenit 16 te LPP-së.**

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkoj një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kane qenë te rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuar për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Gjate vlersimit te aktivitetit te prokurimit për **Furnizimi me uniformë për personelin e Doganës së Kosovës** **Pjesa I:Këmisha dhe kravatë**

Zyra e prokurimit pranë Doganës se Kosovës nuk ka respektuar Ligjin e prokurimit publik dhe aktet tjera ligjore qe e rregullojnë fushën e prokurimit ne Republikën e Kosovës.

Nga kjo pjesë e këtij aktiviteti te prokurimit jemi eliminuar per një qështje krejtesisht te nje leshimi teknik te rastesishem.

Ne si O.E pjesëmarrës ne ketë aktivitet të prokurimit ashtu siq është kerkuar edhe ne dosjen e tendrit dhe në njoftimin për kontratë i kemi dorëzuar Certifikaten e atesteve per te gjithë artikujt nga një laborator i akredituar ashtu siq është kerkuar.

Laboratori i cili i ka kryer keto ateste EUROMAC KONTROL nga Shkupi gjatë perpilimit te rezultateve ka leshuar nje gabim teknik ku rezualtatet e artikullit A3 Kemisha per femra pranvere vere,gjate pershkrimit te peshes per kete artikull, laboratori kompetent i lartpermendur ka bere nje leshim gabimi teknik duke e pershkruar ne kemishat verore per femra peshen e pelhures nga artikulli i kemishave dimrore. Pasi qe kompetentet e laboratorit e kane verejtur kete gabim nderkohe, nga ana e ketij laboratori me 30.12.2016 kemi pranaur informaten se është lëshuar një gabim gjatë përshkrimt te rezultateve te atesteve te realizuara per mostrat e derguara nga ne, informat te cilen jau ka derguar edhe AK-së .

Kjo mund te vereht shumë leht se ka te bëj me gabim teknik pasi qe rezultatet janë te njëjta për te dy artikujt e qka është e pamundur në realitet ta kenë te njejten peshë si këmishat e dimrit po shtu te veres.

Andaj mendojme se Komisioni i vlerësimit nuk e ka respektuar nenin 59 te LPP-se, gjegjesisht pika (i) e nenit 59.4: ku thuhet "Pavarësisht nga e mëparshmja, autoriteti kontraktues mund të konsiderojë një tender si të përgjegjshëm nëse: (i) **përmban vetëm gabime ose paqartësi të cilat mund të korrigjohen pa ndryshuar kushtin material apo aspekin e tenderit ne fjalë",**

Konsiderojme se komisioni i vlersimit nuk e ka respektuar edhe nenin 72 **Dokumentacioni dhe informacioni shtesë** te LPP-se gjegjesisht piken 1 dhe 2 te ketij neni ku thuhet.

1. Kur informacioni apo dokumentacioni që duhet të dorëzohet nga operatorët ekonomikë është ose duket të jetë jo i plotë ose i gabuar, ose kur mungojnë dokumentet specifike, autoritetet kontraktuese mund të kërkojnë nga operatorët ekonomikë qe të dorëzojnë, plotësojnë, sqarojnë apo kompletojnë informacionin apo dokumentacionin e duhur brenda një afati te caktuar kohor, me kusht që kërkesat e tilla bëhen në përputhje të plotë me parimet e trajtimit të barabartë dhe transparencës.

2. Autoriteti kontraktues mund të ftojë operatorët ekonomik për të plotësuar apo të qartësojë certifikatat dhe dokumentet e paraqitura në pajtim me nenet 65-71 të këtij ligji.

Gjate vlersimit te ketij aktiviteti nuk eshte respektuar njeherit edhe neini 39. Sqarimi i Tenderëve konkretisht 39.1, 39.3, 39.4 dhe 39.5 te Udhezuesit Operativ per Prokurim Publik

Si neni 72 i LPP-se po ashtu edhe nini 39 i UOPP-se specifikohet sakte se per cilat dokumete mund te kerkohet informata shtesë.

Lidhur me arsyetimin per tejkalim te buxhetit eshte shkelur neni 16 i LPP-së. Dhe ky arsyetim eshte konfuz me qense ne njoftimin per kontrate ne formularin e e-prokurimit eshte prezatuar vlera e parashikuar e kontrates 625.000,00 euro. Me q'raste vlera e pjeses 1 te tenderit per te cilin jemi eleminuar eshte 338.997.00 euro e cila vlere si pjese e tenderit nuk e tejkalon buxhetin e parapare sipas AK-së.

Andaj konsiderojme se gjate vlersimit nuk jane respektuar nenet e lartecekura.

Dhe ne si OE jemi te demtuar ne menyrë te pa baze nga ana AK-së,

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Mosrespektimi i LPP-se nga AK ne kete raste dhe akteve tjera ligjore ne fushën e prokurimit i shkaktojnë humbje te fititmi te parapare per OE ankues,si dhe humbje te tjera në aspektin e shpenzimeve të pergatitjes se dosjes se tenderi po ashtu shpenzimeve te mostrave, ateseteve si dhe kohes per pergatitjen e te gjithe dokumetacionit te kerkuar

10. Lista e dokumenteve (dëshmive) të bashkangjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.
b) një kopje të publikimit për "Njoftimin e Dhënies së Kontratës" apo "Njoftimin për Rezultatet e Konkursit të Projektimit" apo "Njoftimit për Anulim".
c) një kopje të letrës së eliminimit të tenderuesit/kandidatit/ letrës se tenderuesit të pasuksesshëm/ letrës për mos para-kualifikim.
d) një kopje të procesverbalit të hapjes publike të tenderëve, nëse aplikohet,
e) bashkëngjit një kopje te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se,
f) Dëshminë e pagesës se tarifës se ankimit ne përputhje me nenin 118 te LPP-se, dhe
g) të gjitha korrespondencat e juaja me autoritetin kontraktues duke përfshirë e-mailat si dhe çdo informatë të shkruar që ka të bëjë me këtë aktivitet prokurimi, si dhe me secilin pretendim të paraqitur në ankesë.

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*